



PERSONAT QË KANË VUAJTUR KRIMIN E URREJTJES,
GJUHËN E URREJTJES DHE/ OSE DISKRIMINIMIN PËR
SHKAK TË IDENTITETIN GJINOR DHE ORIENTIMIT SEKSUAL

**GUIDË PËR HAPAT QË MUND TË NDIQNI DHE KU MUND TË
DREJTOHENI PËR NDIHMË**



NË CILAT RASTE JENI PERSON QË VUAJNË NGA KRIMI I URREJTJES, GJUHA E URREJTJES DHE/OSE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË IDENTITETIN GJINOR DHE ORIENTIMIT SEKSUAL?

Krimi i urrejtjes:

Nëse keni përjetuar një akt dhune ose armiqësie për shkak të asaj që ju përfaqësoni apo se dikush mendon se ju jeni, ju mund të keni qenë viktimë e një incidenti urrejtjeje ose krimi të urrejtjes. Krimet e urrejtjes ndodhin për shkak të paragjytimeve ose armiqësive për shkak të aftësisë së kufizuar, racës, fesë, orientimit seksual ose identitetit gjinor të një personi. Krimet e urrejtjes janë krime të motivuara nga paragjykimet. Një rol të madh në përcaktimin e krimeve si krime të urrejtjes është përcaktimi nëse ato janë kryer kundër anëtarëve (të supozuar) të grupeve të shtypura historikisht. Gjithashtu, karakteristikat e mbrojtura me ligj përmendura më sipër, luajnë gjithashtu një rol kryesor në përcaktimin e një incidenti si një krim (të mundshëm) të urrejtjes.

Gjuha e urrejtjes

Termi gjuhë urrejtjeje i referohet shprehjeve publike të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen, diskriminimin ose dhunën ndaj një grupi ose pakice të caktuar-për shembull, deklaratat e bëra nga udhëheqësit politikë dhe fetarë ose udhëheqës të tjerë, të opinioneve ose etiketimeve të qarkulluara nga shtypi ose interneti që synojnë të nxisin urrejtjen.

Diskriminimi

Diskriminimi sipas legjislacionit shqiptar: Është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të

përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Diskriminimi ndodh për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzanisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë së një grupi të veçantë, ose çdo shkak tjetër të ndaluar me ligj.

Pse ka rëndësi që ne të raportojmë çdo rast diskriminimi pranë Policisë?

Rastet e krimeve të urrejtjes dhe diskriminimit karshi komunitetit LGBTI në Shqipëri nuk raportohen, kryesisht për arsye të mungesës së besimit në institucione që garantojnë mbrojtjen dhe sigurinë e komunitetit LGBTI. Që rastet të mund të ndiqen penalisht dhe për të siguruar mbrojtjen dhe parandalimin e më shumë krimeve ndaj komunitetit, është me rëndësi të madhe që ju të raportoni tek autoritetet. Kjo broshurë ju ndihmon dhe do t'ju udhëzojë lidhur me hapat konkretet që duhet të ndërmerri kur jeni viktimë ose dëshmitar i krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe /ose diskriminimit për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual.

SI MUND TË RAPORTONI NJË RAST NË POLICI?

- ⊗ Në rast urgjence, telefononi në numrin e urgjencës 129. Sigurohuni që të kërkonti kujdes mjekësor në rastet kur keni dëmtime në trup.
- ⊗ Në raste jo urgjente, ju mund të shkoni direkt në Komisarariat më të afërt për të paraqitur një ankesë. Oficerët policorë janë të detyruar me ligj të raportojnë incidentin për hetim.
- ⊗ E rëndësishme: nëse doni që krimi të raportohet si një krim i urrejtjes, kërkojini oficerit policor që ta shënojë atë në raport.
- ⊗ Sigurohuni që oficeri të plotësojë një formular të raportimit të incidentit dhe të caktojë numrin e çështjes. Nëse policia nuk ju ndihmon siç duhet, ju keni të drejtë të paraqitni një ankesë. Mund të gjeni më shumë informacion se si të bëni një ankesë më poshtë në këtë broshurë.
- ⊗ Sigurohuni që të merrni kopjen tuaj të raportit policor.

ÇFARË MUND TË BËNI TJETËR?

- ⊗ Ju mund të kërkonti nga mjeku juaj për përcaktimin zyrtar të dëmtimit.
- ⊗ Ju mund të grumbulloni prova të dëmit të pësuar (foto, video, email, mesazhe me tekst, etj.).
- ⊗ Ju mund të kontaktoni një avokat të zgjedhur nga ju. Me iniciativën tuaj, një avokat mund t'ju mbështesë gjatë intervistës nga policia.
- ⊗ Ju mund të kontaktoni OJF-të lokale që mund t'ju ndihmojnë me avokatë falas ose t'ju referojnë në një OJF tjetër që ofron ndihmë ligjore falas. Për më shumë informacion se si të kontaktoni OJF-të lokale, ne kemi shtuar një listë me kontaktet në fund të kësaj broshure.



NJIHNI TË DREJTAT TUAJA:

Në 1973, Shoqata Amerikane e Psikiatrisë (APA) hoqi diagnozën e "homoseksualitetit" nga botimi i dytë i Manualit Diagnostik dhe Statistikor (DSM). Kjo erdhi si rezultat i krahasimeve me teoritë konkurruese; pra ato që patologjizuan homoseksualitetin dhe ato që e shikonin atë si normale. Më 20 Janar 1995, Parlamenti Shqiptar legalizoi marrëdhëniet seksuale konsensuale midis të njëjtës gjini në Shqipëri.

CILAT JANË KËTO TË DREJTA?

- Si person i/e dëmtuar ju mund të raportoni rastin tek oficerët e policisë.
- Para se të raportoni në polici duhet të informoheni se gjithçka që ndani në lidhje me incidentin mund të përdoret si provë para gjykatës.
- Mbani në mend se gjithçka që do të ndani gjatë intervistës me policët do të shkruhet dhe shënohet.
- Ju keni të drejtë të kërkonti një avokat i cili mund t'ju ndihmojë gjatë intervistës nëse nuk keni mundësi financiare për një të tillë. Në fund të kësaj broshure mund të gjeni kontaktet e OJF-ve lokale të cilat mund t'ju ndihmojnë me avokatë falas ose t'ju referojnë në një OJF tjetër që ofron ndihmë juridike falas.
- Pas depozitimit të raportit tek oficerët e policisë, ju keni të drejtë të kërkonti ndihmë nga një psikolog ose mund t'i drejtoheni Njesisë për Mbështetjen e Viktimave.

ÇFARË DUHET TË BËNI NË RAST REFUZIMI TË MARRJES SË ANKESËS NGA ANA E POLICISË:

- Këmbëngulni dhe kërkonti arsyet e refuzimit.
- Pyesni nëse mund të flisni me një mbikëqyrës ose shef policie.
- Paraqitni një ankesë në Sherbimi për ceshtje të brendshme dhe ankesat.
- Raportoni refuzimin te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Raportoni refuzimin tek Avokati i Popullit.
- Shkoni tek OJQ-të tuaja lokale LGBTI, Aleanca Kunder Diskriminimit LGBT, Te bashkuar Pro Kauzes LGBT, për t'i njoftuar ata mbi refuzimin dhe për të diskutuar mbi hapat e mundshme.

Për më shumë informacion në lidhje me personat dhe organizatat e mësipërme dhe si t'i kontaktoni ata, sigurohuni që të shikoni listën e kontakteve që kemi shtuar në këtë broshurë.

AKRONIMET LGBTIQ:

Orientim Seksual: Tërheqje seksuale e natyrshme. Prirja ose aftësia për të zhvilluar marrëdhënie intime emocionale ose seksuale me njerëz që i përkasin kategorisë të së njëjtës gjini, gjinisë së kundërt apo më shumë se një gjinie. Përdorni këtë term në vend të preferencës seksuale ose terminologjive të tjera jo të përshtatshme.

Identitet Gjini: Është mënyra se si një njeri vet-identifikohet me një kategori gjinore, si për shembull të jesh burrë ose grua, apo në disa raste asnjë prej tyre, i cili mund të jetë i dallueshëm nga seksi biologjik. Një person mund të ketë përputhshmëri me identitetin e tij gjini (p.sh., gjinia fizike dhe identiteti gjini i tij/saj janë në përputhje të plotë) ose transgjini (lindur biologjikisht me një gjini, por emocionalisht ose shpirtërisht me tjetrën) ose asnjëra plotësisht.

Strejt (Straight): Heteroseksual; jo-gej. Term i huazuar nga anglishtja që preferohet nga disa njerëz, pasi nuk është formal dhe klinik, siç është termi heteroseksual.

Gej (Gay): Një mbiemër që ka zëvendësuar gjerësisht fjalën "homoseksual" kur i referohemi meshkujve që janë seksualisht dhe emocionalisht të tërhequr nga meshkuj të tjerë.

Lesbikë: Term i preferuar, si në formën e emrit ashtu edhe mbiemrit, për femra që janë emocionalisht dhe seksualisht të tërhequra nga femra të tjera.

Biseksual: Individët që tërhiqen emocionalisht dhe seksualisht nga të dyja sekset. Nuk supozon ose hamendëson poligami. Disa njerëz identifikohen si "bi" në vend të biseksualë.

I/e mbyllur në sirtar (Closeted): I referohet një personi që mban të fshehur orientimin e tij/saj seksual ose identitetin gjini.

Dalja hapur (Coming out): Procesi i njohjes, ndërgjegjësimit dhe pranimit të orientimit jo-heteroseksual ose identitetit gjini me veten dhe pastaj ndarja me të tjerët. Fillimisht, shumë të rinj lgbt, ngrenë barriera emocionale kundrejt të njohurve të tyre, miqve dhe familjarëve duke pretenduar (konkretisht ose nëpërmjet heshtjes) se janë heteroseksualë. Dalja hapur zakonisht ndodh me etapa, dhe është një proces jo linear.

Homofobia: Term që tregon frikën e paarsyeshme nga homoseksualiteti. Ky term i referohet zakonisht të qenit kundër ose mospëlqyes ndaj personave gej, lesbikë, biseksualë dhe transgjini ose sjelljes stereotipike gej/lesbikë.

Transgjini: Term që po preferohet shumë nga njerëz, pamja, karakteristikat ose sjelljet e të cilëve janë jo konformë roleve gjinore...individë që ndryshe do të vetëquheshin transeksualë. Transgjini mund të jenë heteroseksualë, gej, lesbikë ose biseksualë. Disa njerëz vetëidentifikohen si trans më shumë se transgjini.

LISTA ME KONTAKTET KRYESORE

A DONITË DINI MË SHUMË MBIKTË TEMË?

Ju lutem drejtohuni te faqet tona të internetit listuara më poshtë ose na kontaktoni.

Aleanca Kunder Diskriminimit LGBT

www.aleanca.al

www.soslgbt.al

Email: aleanca.al@gmail.com

Numri telefonit: +355 693053764

Te bashkuar Pro kauzes LGBT

www.prolgbtalbania.org

www.historia-ime.com

Email: historiaime.com@gmail.com

Streha LGBT

www.strehacenter.org

Email: strehalgbt@gmail.com

Numri telefonit: +355 69 98 39 189

Institucione të tjera të rëndësishme: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

www.kmd.al

Address: Rruga e Durrësit Nr.27, Tirana

Email: info@kmd.al

Cel: 04 243 1077

Avokati i Popullit

www.avokatipopullit.gov.al

Address: Rruga Vllazën Huta, Tiranë

Cel: 068 554 2604

Sherbimi per ceshtje te brendshme dhe ankesat,

www.shcba.gov.al

Address: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nd. 1, 1001 Tiranë

Email: info@shcba.gov.al

Numri Jeshil: 0800 90 90

Nidhma ligjore falas

Ministria e Drejtësisë

www.ndihmajuridike.gov.al

Numri Jeshil: 0800 10 10